



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI I LËNDËS
LETËRSI E GJUHËS 4

Titullari /pedagogu i lëndës: Msc (Dr. Proc) Aida Zoto
Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë (20 leksione, 20 seminare)
Tipologjia e lëndës: B
Viti akademik: 2023-2024, Cikli I, viti III, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Greke me profil “Gjuhë letërsi dhe qytetërim grek”
Kodi i etikës Kodi i etikësi UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)
Adresa elektronike: aida.zoto@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë synon të pajisë studentin me njohuritë bazë dhe themelore për gjithë zhvillimin e letërsisë së re greke, që nga Brezi i viteve 1920 deri në 1960/70 (mbarimi i modernizmit). Kjo periudhë mbulon një larmishmëri zhvillimesh letrare dhe artistike, jo vetëm në Greqi, por në mbarë Evropën. Trajtohet në mënyrë të veçantë lëvizja e modernizmit, surrealizmit dhe simbolizmit. Me njohjen e këtyre tendencave dhe zhanreve letrare, studenti do të thellojë njohuritë e tij mbi zhvillimet e tyre në letërsi, në kombinim me përfaqësuesit e secilës prej tyre në Greqi dhe veprat e tyre kryesore.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- ✓ Njohuri mbi zhvillimet e letërsisë së re greke përgjatë shekujve IX-XX;
- ✓ vazhdimi i zhvillimit të modernizmit;
- ✓ brezi i viteve 1930;
- ✓ shfaqja e surrealizmit dhe përfaqësuesit kryesorë në poezi dhe prozë;
- ✓ letërsia e pasluftës (1945) dhe përfaqësuesit kryesorë në poezi dhe prozë.

Objektivat specifike lëndore:

- ✓ Studentët do pajisen me njohuri të thelluara mbi zhvillimet letrare më të qenësishme të letërsisë së re greke në periudhën shek. IX-të deri në XX-të, si edhe me përfaqësuesit e saj;
- ✓ Ata do të përfitojnë njohuri më të zgjeruara në aspektin letrar, historik, filologjik dhe gjuhësor.

LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme:

1. Ιστορία της νεοελληνικής λογοτεχνίας / Mario Vitti , μετάφρ. Μυρσίνης Ζορμπά ,

θεώρηση του συγγραφέα , απόδοση Ε. Ι. Μοσχονά. Creator: Vitti, Mario, Publication Date: 1978.

<file:///C:/Users/Aida%20Z/Downloads/Vitti%20-%20CE%99%CF%83%CF%84%CE%BF%CF%81%CE%B9%CC%81%CE%B1%20%CF%84%CE%B7%CF%82%20%CE%BD%CE%B5%CE%BF%CE%B5%CE%BB%CE%BB%CE%B7%CE%BD%CE%B9%CE%BA%CE%B7%CC%81%CF%82%20%CE%BB%CE%BF%CE%B3%CE%BF%CF%84%CE%B5%CF%87%CE%BD%CE%B9%CC%81%CE%B1%CF%82.pdf>

2. Linos Politis, Ιστορία της νεοελληνικής λογοτεχνίας, Historia e Letërsisë së Re Greke, Botimet Dhodhoni, Athinë 1992

b) Literatura e rekomanduar:

1. Roderick Beaton, Εισαγωγή στην νεοελληνική λογοτεχνία, Hyrje në letërsinë e re greke, Botimet Nefeli, Athinë 1996
2. Mitsou Lijizou, θέματα και ποιητές, Δοκίμια και μελέτες, Cështje dhe poetë, Ese dhe studime, Botimet Dhodhoni, Athinë 1997
3. Apostolos Saqini, Προσεγγίσεις, Përafrime, Botimet Instituti i librit M. Kardhamitsa, Athinë 1989